

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PARKINSAN

Tableta - 5 mg
(Triheksifenidil klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Parkinson dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Parkinson
- Si ta merrni Parkinson
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Parkinson
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PARKINSAN DHE PËRSE PËRDORET

Parkinsan përmban lëndën vepruese triheksifenidil klorhidrat. Ai është një antimuskarinik me veprime të ngjashme me ato të atropinës. Ai ushtron efekt frenues të drejtpërdrejtë në sistemin nervor parasimpatik duke frenuar veprimet e acetilkolinës. Parkinson ushtron edhe veprim antispazmodik në muskulaturën e lëmuar.

Parkinsan – tabletë 5 mg indikohet si:

- ndihmës në mjekimin e të gjitha formave të parkinsonizmit (pasencefalik, arteriosklerotik dhe idiopatik);
- ndihmës gjatë mjekimit me levodopa të formave të mësipërme të parkinsonizmit. Ai ndihmon në uljen e rigiditetit (shtangësisë) të spazmave muskulore dhe në reduktimin e shtimit të theksuar të pështymës që shoqëron parkinsonizmin;
- mjekim ndihmës me levodopa për kontrollin e çrregullimeve ekstrapiramidale të shkaktuara nga barnat që veprojnë në sistemin nervor qendror.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PARKINSAN

Mos merrni Parkinson nëse vuani nga:

- mbindjeshmëri ndaj triheksifenidilit, ose ndaj ndonjëres prej lëndëve ndihmëse të përmendura në këtë fletëudhëzues
- mbajtja e patrajtueshme e urinës
- glaukoma me kënd të ngushtë
- obstruksion gastrointestinal
- miastenia gravis.

Tregoni kujdes të veçantë me Parkinson

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Parkinson:

- nëse jeni të sëmurë me aritmi (kryesisht takikardi), hipertension, hipotension;

- nëse keni hipertrofi të prostatës;
- nëse keni çrregullime të mëlçisë ose të veshkave;
- nëse keni megakolon.

Kujdes duhet treguar në mót të nxehtë sepse mund të shfaqet një pakësim i sekrecioneve dhe hipertermi fatale. Triheksifenidili mund të bëhet subjekt i abuzimit (bazuar në vetitë e tij halucinogjene dhe euforike e që janë të zakonshme për të gjithë antikolinergjikët) në qoftë se përdoret në doza të konsiderueshme.

Në përgjithësi, antikolinergjikët duhen përdorur me kujdes në të sëmurët që marrin antidepresivë triciklikë ose frenues të monoaminooksidazës (IMAO). Në të sëmurët që janë duke përdorur antidepresivë, doza e triheksifenidilit në fillim duhet ulur dhe i sëmuri duhet mbikëqyrur me kujdes. Meqenëse të moshuarit dhe pacientët arteriosklerotikë janë më të ndjeshëm ndaj efekteve anësore të antimuskarinikëve, rekomandohet doza më e ulët e intervalit të dozave efikase.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Parkinson. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Parkinson në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit, sidomos të mëposhtmit:

- barna të tjerë antimuskarinikë:** përdorimi në të njëjtën kohë i dy-tre barnave të tillë mund të shtojë efektet anësore, si: tharjen e gojës, mbajtjen e urinës dhe konstipacionin. Përdorimi i njëkohshëm i tyre tek të moshuarit mund të çojë në konfuzion;
- antiaritmikë:** rritje e efekteve antimuskarinike me disopiramid;
- antihistaminikë:** rritje e efekteve anësore antimuskarinike;
- antimykotikë:** ulje e përthithjes së ketokonazolit;
- haloperidol:** simptomat e skizofrenisë mund të përkeqësohen kur triheksifenidili përdoret njëherësh me haloperidolin sepse nivelet e haloperidolit mund të ulen dhe të shfaqet diskinezi tardive;
- fenotiazina:** veprimet e tyre mund të ulen nga triheksifenidili;
- antidepresivë triciklikë ose frenues të monoaminooksidazës (IMAO):**
- amantadinë:** mund të theksohen efektet e padëshirueshme antimuskarinike;
- nitrate:** ulje e efektit të nitrateve që mbahen nën gjuhë (vonesë e tretjes nën gjuhë për shkak të tharjes së gojës).

Shtatzënia

Parkinsan nuk duhet përdorur gjatë periudhës së shtatzënisë, përveç rastit kur përfitimi tejkalon risikun! Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Mjeku duhet të vlerësojë risikun ndaj të cilit ekspozohet fetusi dhe përfitimin e nënës nga trajtimi me Parkinson.

Ushqimi me gj

Parkinsan nuk duhet të përdoret gjatë periudhës së ushqyerjes së foshnjës me gjil! Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Parkinsan mund të shkaktojë shikim të turbullt ose ulje të vigjilencës, kështu që duhet treguar kujdes në rast drejtimi të automjetit ose përdorimi të makinerive.

Informacione të rëndësishme për disa nga përbërësit e Parkinsan

Kjo tabletë përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj se vuani nga intoleranca prej disa sheqernave, kontaktoni me mjekun përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI PARKINSAN

Gjithmonë merreni Parkinson sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Parkinsan janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të gëlltiten në një gotë ujë.

Dozimi i tabletës është si vijon:

Në sëmundjen e Parkinsonit jepet në 3-4 doza të ndara në ditë, përpara ose bashkë me ushqimin. Doza e zakonshme fillestare prej 1 mg/ditë rritet gradualisht në intervale prej 3-5 ditësh me 2 mg deri në 6-10 mg/ditë në varësi të përgjigjes. Në rastet e avancuara mund të nevojiten 12-15 mg/ditë ose më shumë. Si rregull, pacientët postencefalitkë kërkojnë dhe tolerojnë dozat më të larta.

Në simptomat ekstrapiramidale të induktuara nga barnat dozat e zakonshme janë ndërmjet 5 – 15 mg / ditë, megjithëse në disa raste mund të mjaftojë edhe doza 1 mg / ditë.

Meqenëse të moshuarit dhe pacientët arteriosklerotikë janë më të ndjeshëm ndaj efekteve anësore të antimuskarinikëve, rekomandohet doza më e ulët e intervalit të dozave efikase. Trajtimi me antimuskarinikë i parkinsonizmit nuk duhet të ndërpritet menjëherë dhe nëse do kalohet nga një bar tek një tjetër, duhet ulur gradualisht doza e njërit ndërkohë që rritet doza e barit tjetër.

Ky bar mund të jepet i shoqëruar me barna të tjera për lehtësimin e parkinsonizmit, por doza e secilit bar duhet reduktuar.

Në qoftë se keni marrë më shumë Parkinsan

Në qoftë se keni marrë më shumë Parkinsan se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Parkinson

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se ndërprisni marrjen e Parkinsan

Ndërprerja e menjëhershme duhet evituar. Reduktimi i dozës duhet të bëhet gradualisht. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjerë, Parkinsan mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- në sistemin kardiovaskular (takikardi, palpitacione, hipotension);
- në sistemin nervor qendror (marrje mendsh, nervozizëm, manifestime psikiatrike, si: deluzione ose halucinacione, konfuzion mendor, axhitim, çrregullime të sjelljes);
- në aparatën gastrointestinal (tharje goje, të përziera, të vjella, konstipacion, parotit supurativ, ileus paralitik, zgjerim i zorrës së trashë);
- ekzantema;
- turbullim i të parit;
- mbajtje e urinës; impotencë;
- ethë; skuqje e fytyrës dhe pakësim i djersitjes.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PARKINSAN

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Parkinsan pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim!
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM


Çfarë përmban Parkinsan
Lënda vepruese është triheksifenidil klorhidrat. Çdo tabletë përmban 5 mg triheksifenidil klorhidrat.
Përbërës të tjerë: laktozë, celulozë mikrokristalorë, talk dhe stearat magnez.


Përbajtja e paketimit

Kuti me 30 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

 Sipas recetës së mjekut.

 Përbajtja.  Kujdes.

 Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:

 **PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2015.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm